



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11 Korrik 2023

Nr: 690

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 415 DHE 416 ID PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

Data: 11 Korrik 2023

Nr: 690
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 415 dhe 416 ID.”

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 11.5.2023, është administruar shkresa nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK , i regjistruar me nr. 415 ID, me lëndë “Aktivitet elektoral”, me objekt denoncimi “Organizimi i koncertit të Kandidatit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për Kryetar të Bashkisë Tiranë, z. Belind Këlliçi. Në pamjet foto dhe video të postimeve të paraqitura në vijim të këtij denoncimi evidentohet qartë thirrja dhe organizimi i veprimtarisë “koncert” si dhe prezenca e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” dhe Kandidatit të tij për Kryetar të Bashkisë Tiranë për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023.”

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 11.5.2023, është administruar shkresa nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara KRIIK , i regjistruar me nr. 416 ID, me lëndë “Aktivitet elektoral”, me objekt denoncimi “Organizimi i koncertit të Kandidatit të Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetar të Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj. Në pamjet foto dhe video të postimeve të paraqitura në vijim të këtij denoncimi evidentohet qartë thirrja dhe organizimi i veprimtarisë “koncert” si dhe prezenca e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe Kandidatit të tij për Kryetar të Bashkisë Tiranë për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023.”

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi dministrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve nr. 415 dhe 416 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI